



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SOLEMNE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 16 SHKURT 2017**

**SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 16. FEBRUARA 2017. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2017**

Rendi i ditës

1. Shënimi i 9-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës

Dnevni red

1. Obeležavanje 9-godišnjice proglašenja nezavisnosti Kosova

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar president i Republikës së Kosovës, shkëlqesia juaj, zoti Hashim Thaçi,
I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa,
I nderuar kryeministër i Republikës së Shqipërisë, zoti Edi Rama,
I nderuar ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zoti Greg Delawi,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare,
E nderuar ambasadore e Bashkimit Evropian në Republikën e Kosovës, zonja Natalia Apostolova,
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misionëve diplomatike në Republikën e Kosovës,
Shumë të nderuar mysafirë, që na keni nderuar në mënyrë të veçantë, kolegët tanë parlamentarë nga Britania e Madhe, që sot i kemi mysafirë, njëkohësisht e përshëndesim edhe konsullin e nderit të Republikës së Kosovës në Japoni, zotin Isao Ixhima.

Të nderuar zonja dhe zotërinj të pranishëm,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Mirë se keni ardhur në seancën solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me rastin e kremtimit të 9-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Ju lutem, të ngrihemi në këmbë për himnin kombëtar të Kosovës.

Të nderuar të pranishëm,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Tani e ftoj presidentin e Republikës së Kosovës, shkëlqesinë e tij, zotin Hashim Thaçi, që t'i drejtohet me një fjalë sallës së Kuvendit dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës.
Urdhëroni, zoti President!

PRESIDENTI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Kadri Veseli!
I nderuar kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa,
Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, zoti Edi Rama,
I nderuar ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zoti Delawi,
Të nderuar përfaqësues të korit diplomatik,
Ambasadorë,
Të nderuar mysafirë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ju përshëndes në emër të Presidencës!

Më lejoni të filloj duke ju uruar në këtë përvjetor të nëntë të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Më lejoni gjithashtu t'ju përcjell urimet që kemi pranuar nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump.

Jemi përherë mirënjohës për miqësinë tonë dhe për marrëdhënien tonë speciale.

Jemi krenarë të jemi partnerë dhe të ndajmë vlera dhe interesa të përbashkëta për vendet tona, për botën.

Këshillat dhe ndihma e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kanë qenë gjithmonë në thelb të progresit tonë si shtet dhe komb.

U jemi mirënjohës të gjitha shteteve të Bashkimit Evropian, të NATO-s dhe të gjitha shteteve që e kanë njohur Republikën e Kosovës, 113 prej tyre.

Gjithashtu, më lejoni t'ju përcjell urimet e përzemërta që kemi marrë nga liderët e tjerë botërorë.

I falënderojmë përzemërsisht të gjithë krerët e shteteve e të qeverive të vendeve që kanë dërguar urimet e tyre për këtë ditë të shënuar për Kosovën.

Në fakt, kjo është ditë e shenjtë për ne dhe për gjeneratat që do të vijnë.

Është dita kur janë kurorëzuar sakrificat dhe ëndrra që edhe qytetarët e Kosovës të jetojnë të lirë, të barabartë me të tjerët, në shtetin e tyre.

E kemi dëshiruar këtë ditë, jemi shkrirë për këtë ditë, kemi duruar për këtë ditë, jemi flijuar dhe kemi fituar për këtë ditë.

Sot, fjala e parë, mendimi i parë është për të gjithë ata që dhanë çdo gjë që patën që ne të gëzojmë këtë ditë.

Sot, jemi më afër se çdo ditë tjetër me heronjtë tanë, me dëshmorët tanë, me familjet e dëshmorëve, me invalidët, me familjet e të pagjeturve.

Prandaj, 17 Shkurti është ditë e shenjtë për Kosovën.

Është vetë historia e Kosovës.

Është Dita e Republikës.

Të nderuar të pranishëm,

Deputetë të nderuar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Nëntë vjet më parë, këtu në këtë Kuvend, ka përfunduar një ëndërr për të filluar një ëndërr tjetër, apo ëndrrën e shndërruar në realitet.

Ka përfunduar një angazhim për të filluar një tjetër.

Ka përfunduar puna për lirinë dhe shtetin e Kosovës.

Dhe, ka filluar angazhimi për një Kosovë në NATO dhe në Bashkimin Evropian.

Për një Kosovë të ndërtuar mbi vlerat dhe parimet e lirisë, të barazisë, të drejtësisë dhe të gjithëpërfshirjes.

Për një Kosovë të të gjithë qytetarëve të saj, ku secili do të jetë i lirë të gjejë lumturinë e tij, pa u cenuar nga të tjerët dhe pa cenuar të tjerët.

Sot, kur vlerësojmë këto nëntë vjet, e kuptojmë se sa larg kemi arritur.

Nga sfidat e përditshme nganjëherë nuk i shohim hapat e mëdhenj që kemi bërë të gjithë, pa dallim, bashkërisht.

Por, janë vëllezërit dhe motrat tona nga diaspora që vijnë për vizitë në shtëpitë e tyre, që na e kujtojnë se sa shumë është zhvilluar Kosova, sa është ndërtuar shteti ynë, me gjithë vështirësitë, pengesat dhe lëshimet që ndodhin.

Janë ndërtuar qytete të reja, fshatra, shkolla, ara, janë shtruar rrugë dhe autostrada të reja. Pra, sot e kemi një Kosovë të re, me ambicie për në Bashkimin Evropian.

Por, diçka ka mbetur pa ndryshuar.

Kjo është dashuria jonë për shtëpinë tonë, për njëri-tjetrin.

Mbi këtë dashuri për vendin tonë po punojmë të ndërtojmë të ardhmen tonë më të mirë për ne dhe për gjeneratat që vijnë.

Zonja dhe zotërinj,

Cilat janë disa nga arritjet e Kosovës në këto 9 vjet?

Kosova sot është e njohur si shtet nga 82 për qind e vendeve të Bashkimit Evropian, 86 për qind e vendeve të NATO-s, 56 për qind e OKB-së, 100 për qind e Forumit të Ishujve të Pacifikut, 61 për qind e Organizatës së Bashkëpunimit Islamik, 57 për qind e KARIKOM-it dhe 49 për qind e Unionit Afrikan.

Kemi ndërtuar institucione demokratike që u bëjnë ballë sfidave të politikës.

Kemi ndërtuar policinë më profesionale në rajon.

Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës garojnë në stërvitjet më të vështira në botë dhe kthehen me mirënjohje të lartë.

Kemi integruar të gjitha komunitetet dhe punojmë çdo ditë, që asnjë qytetar të mos ndihet i përjashtuar, pa marrë parasysh përkatësinë e tij etnike, religjioze, gjininë apo orientimin seksual.

Kemi ndërtuar marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët tanë, madje kemi vënë marrëdhënie bashkëpunimi edhe me Serbinë.

Sot, në mediet e botës Kosova më nuk zë vend për storiet e luftës apo të krizës, por atë për promovimin e paqes dhe të dialogut.

Por, bota sot di për Kosovën edhe më shumë, duke iu falënderuar sportistëve dhe artistëve të Kosovës.

Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Rita Ora, Dua Lipa, ekipi i filmit “Home” apo ai i filmit “Shok”, futbollistët dhe basketbollistët tanë, sportistët e tjerë me sukseset e tyre anekënd botës. Kjo është Kosova që sot sheh bota.

Është kjo Kosova e njerëzve që nuk dorëzohen, e ndërmarrësve, e punëtorëve, e grave dhe e burrave që gjejnë forcë që mbi dhimbjen dhe shkatërrimin e luftës të ndërtojnë shtet mbi dashurinë, solidaritetin dhe respektin për njëri-tjetrin.

Kjo është fitorja jonë më e madhe.

Kjo është fitorja e qytetarëve të Kosovës.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,
Të nderuar të pranishëm,

Këtu nuk merr fund puna jonë.

Sot festojmë dhe kujtojmë sakrificat dhe arritjet tona.

Por, sot zotohemi se do të vazhdojmë të punojmë për të ndërtuar shtëpinë tonë, Kosovën në NATO dhe në Bashkimin Evropian.

Kjo do të kërkojë të njëjtin përkushtim, të njëjtin zell nga ne, sikur deri tani.

Mund të dallojmë në bindjet tona politike si parti politike, në pikëpamjet tona për botën apo shoqërinë, por duhet të jemi unikë në përkushtimin tonë për të ruajtur shtetin e Kosovës.

Vetëm duke forcuar shtetin tonë, Kosovën tonë, mund të realizojmë edhe ambiciet tona.

Pra, Kosova, mbi të gjitha dhe për të gjithë.

Sot, jetojmë në një botë që po ndryshon shpejt, në kohë ndryshimesh që nuk mund t'i parashikojmë, por nga e kaluara jonë e dimë shumë mirë se nëse qëndrojmë të bashkuar, të vendosur, të drejtë, projekti ynë për shtetin e Kosovës do të ketë sukses edhe më të madh.

Prandaj, edhe një herë, gëzuar këtë ditë të shenjtë të gjithë qytetarëve të Kosovës, të gjithë juve që jeni prezentë në këtë sallë!

Zoti e bekoftë Kosovën!

Zoti i bekoftë miqtë e Kosovës!

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar President i Republikës! Tani, e ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Isa Mustafa, që ta marrë fjalën. Urdhëroni, zoti Kryeministër!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Veseli!

I nderuar President i Republikës së Kosovës, Shkëlqesia juaj, z. Hashim Thaçi, I nderuar kryeministër i Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar përfaqësues të Korit diplomatik,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është nder për mua që t'ju drejtohem në këtë ceremoni shtetërore të nëntëvjetorit të pavarësisë së shtetit tonë, në këtë datë, ku janë sublimuar vlerat më të larta të idealeve, aspiratave, kontributit dhe vizionit të popullit tonë.

Kjo datë dhe kjo ditë është futur në historinë tonë. Ajo nuk është futur rastësisht, por është kontribut i dekadave të punës, vizionit dhe të përkushtimit të popullit tonë për të jetuar të lirë dhe të barabartë me kombet e botës.

Prandaj, në këtë përvjetor u jemi mirënjohës të gjithë atyre që kanë shkrirë mendjen dhe kanë dhënë jetën që Kosova sot të frymojë e lirë, sovrane, e pavarur dhe demokratike.

Ky kontribut i patriotëve shqiptarë ndër shekuj dhe dekada kulmoi në vitet e 90-ta me Presidentin historik dhe ideologun e shtetit tonë, Dr. Ibrahim Rugova, i cili aspiratën tonë për liri, pavarësi dhe demokraci e bëri realitet dhe mori përkrahjen e miqve tanë euro-atlantikë.

Vizioni rugovian për liri dhe paqe në Ballkan, në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me vendet e Bashkimit Evropian, vazhdoi me luftën çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me Komandantin legjendar, Adem Jashari. Këto janë vlerat tona kombëtare, janë vlerat universale, që dëshmojnë se edhe popujt e vegjël, në gjirin e tyre rrisin njerëz të mëdhenj.

Në nëntëvjetorin e pavarësisë Kosova është një vend demokratik që prodhon paqe në Ballkan dhe është pjesë e të gjitha iniciativave rajonale, evropiane dhe globale që promovojnë siguri dhe prosperitet për shtetet tona. Por, në rast të provokimeve që cenojnë sovranitetin tonë, Kosova vepron me maturi si shtet kredibil.

Për këto vite, Kosova, në bashkëpunim me aleatët tanë euro-atlantikë, ka konsoliduar demokracinë dhe i ka forcuar institucionet shtetërore për të garantuar sovranitetin tonë dhe të drejtat e të gjithë qytetarëve, pa dallim.

Si demokraci e re, Kosova ka dhënë dëshmi të fuqishme për luftën kundër terrorizmit dhe radikalizmit të dhunshëm dhe kjo është thënë publikisht nga miqtë tanë amerikanë dhe evropianë.

Kosova po bëhet gjithnjë e më shumë vend i mundësive të reja për të gjitha komunitetet dhe për të gjithë qytetarët e saj, pa dallim etnie, fetare apo dallime të tjera, ndërkaq të gjitha dallimet në Kosovë gjithnjë e më shumë po shndërrohen në begati dhe në forcën tonë të përbashkët.

Të nderuar të pranishëm,

Përvjetori i Pavarësisë është edhe një datë kur numërojmë punët e mira që kemi bërë, por edhe prezantojmë synimet për të ardhmen.

Viti që e lamë pas kishte arritje të konsiderueshme në forcimin dhe konsolidimin e shtetësisë sonë të brendshme dhe në ndërkombëtarizimin tonë në arenën ndërkombëtare.

Për herë të parë nga prilli i vitit të kaluar Kosova vendosi në fuqi një marrëveshje kontraktuale me Bashkimin Evropian, dhe ajo është Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, që e bëri vendin tonë pjesë të pandashme të një tregu prej mbi 500 milionë banorësh dhe të një arene tepër të rëndësishme për ne.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që në këtë përvjetor të nëntë të shtetit tonë të jap edhe një lajm të mirë për Kosovën. Them se në saje të rritjes së vazhdueshme ekonomike, po arrijmë që këtë vit të dalim nga pragu i varfërisë dhe, sipas kriterëve të Bankës Botërore, nga ky vit vendi ynë do të konsiderohet vend me të ardhura të mesme.

Mbetet që ne të punojmë shumë, që t'i thellojmë rezultatet tona dhe që t'i përmbushim të gjitha kërkesat që qytetarët i kanë para nesh.

Agjenda e integritimeve evropiane është pika ku na bashkon të gjithëve në Kosovë, pavarësisht bindjeve politike dhe pavarësisht përkatësive etnike. Klasa politike, ekzekutivi, ligjvënësit, bota akademike dhe shoqëria civile duhet t'i tejkalojnë dallimet e vogla, për të marrë vendime të rëndësishme për të ardhmen e vendit dhe për të ardhmen e fëmijëve tanë.

Ne do të dëshmojmë para qytetarëve dhe para miqve tanë se kur është fjala për interesa madhore kombëtare, jemi të gjithë të bashkuar.

Kosova do të forcohet dhe do të zhvillohet për t'u dhënë rast dhe për të dëshmuar para aleatëve tanë se investimi në vendin tonë është investim për liri, është investim për paqe dhe investim për të gjitha të mirat që ne duhet t'i gëzojmë bashkërisht në këtë rajon dhe më gjerë.

Kosova ka sfida, por Kosova ka stabilitet makroekonomik dhe buxhetor, ka institucione të forta dhe të afta demokratike, ka orientim të qartë evropian dhe euro-atlantik, prandaj ardhmëria e saj është forcë dhe siguri e saj.

Kërkesën e disave për të shkuar në zgjedhje, që për neve do të ishte alternativa më e lehtë, e kemi zëvendësuar me alternativën më të rëndë, me përkushtimin tonë për të punuar, për të bërë zgjidhje për problemet me prioritet për Kosovën, zgjidhje për liberalizimin e vizave, zgjidhje për zhvillimin ekonomik, zgjidhje për implementimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, zgjidhje për avancimin e të drejtave të të gjithë qytetarëve dhe të gjitha komuniteteve në vendin tonë dhe zgjidhje për shtrirjen e sovranitetit tonë në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Të nderuar qytetarë, të nderuar deputetë,
Në emër të Qeverisë jua uroj Festën e Pavarësisë, duke i dëshiruar atdheut tonë, Kosovës, paqe, prosperitet dhe integrim në familjen tonë të përbashkët evropiane. Gëzuar!

KRYETARI I KUVENDIT, KADRI VESELI: Faleminderit, i nderuar Kryeministër!

Tani, më lejoni që në këtë përvjetor të Pavarësisë së Kosovës t'ju drejtohem me një fjalë rasti.

Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Shumë i nderuar kryeministër i Republikës së Shqipërisë, që sot jeni prezent së bashku me ne në këtë ditë të madhe, për arsye se 17 Shkurti për ne, qytetarët e Republikës së Kosovës, është jo vetëm ditë e madhe, po dita më e madhe e popullit tonë, është data që ndan epokat, që i jep kuptim të kaluarës sonë dhe të ardhmes që kemi përpara.

Në këtë ditë feste e gëzimi, ne kthejmë shikimin nga e kaluara, për të nderuar kujtimin e burrave dhe grave të Kosovës, që për një shekull rresht nuk kursyen as mundin, as jetën e tyre për lirinë dhe pavarësinë e atdheut tonë.

Ata ishin luftëtarë, si Isë Boletini, Azem Bejta, Hasan Prishtina, Bajram Curri e Shaban Polluzha, që nuk u dorëzuan kurrë para shovinizmit dhe brutalitetit të pushtuesve.

Ata ishin intelektualë e veprimtarë që ndoqën rrugën dhe vizionin e simbolit të kombit, heroit të gjallë, Adem Demaçi e Metush Krasniqi. Ata ishin studentët trima të viteve '68, '81, '90. Ata ishin akademikët, arsimtarët, mjekët, studentët, minatorët e fermerët, ishte rezistenca jonë paqësore, e cila u pasua me luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për të kthyer në realitet ëndrrën e gjatë të popullit tonë për liri dhe shtet.

I përjetshëm do të jetë kujtimi për ta, ashtu si do të jetë i përjetshëm dhe i palëkundur në rrugëtimin e vet shteti ynë i pavarur dhe sovran, Republika e Kosovës.

Të nderuar të pranishëm,

Miq të nderuar,

Zonja dhe zotërinj,

Në këtë ditë feste dhe gëzimi, bashkë me të gjithë qytetarët e Kosovës, ne shprehim nderimin dhe mirënjohjen për botën demokratike, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, falënderojmë ambasadorin që e kemi këtu para nesh, shtetet e Bashkimit Evropian, e falënderojmë përfaqësuesen e Bashkimit Evropian, po ashtu e pranishme në sallë dhe shtetet mike gjithandej botës.

Janë këto shtete që mirëkuptuan dhe mbështetën në mënyrë vendimtare kauzën tonë të drejtë për liri, pavarësi dhe shtet.

E krijuar në kohë të vështira, aleanca e vendit tonë me këto vende për ne mbetet vlerë kombëtare, vizion gjeostrategjik dhe identitet civilizues.

E tillë do të mbetet përgjithmonë.

Ne kemi qenë, jemi dhe përgjithmonë do të mbesim shtet evropian, shtet perëndimor, për arsye se ky është shpirti ynë, ky është identiteti ynë, ky është vetë ne, ajo çfarë jemi, Republika e Kosovës, populli i Kosovës.

Të nderuar të pranishëm,

Zonja dhe zotërinj,

Në këtë ditë feste, ne si përfaqësues të popullit duhet të bëjmë edhe bilancin e punëve tona.

A jemi duke bërë atë që presin nga ne qytetarët e Republikës sonë?

A jemi duke ecur në drejtim e duhur?

Çfarë po ndodh me ekonominë tonë?

Janë këto pyetje që shprehin brengat më të mëdha të qytetarëve tanë dhe ne jemi këtu pikërisht për t'u dhënë përgjigje dhe zgjidhje.

Nuk kemi punë tjetër, dhe nuk ka nder më të madh se sa t'i shërbesh atdheut tënd.

Në këto 9 vjet të ekzistencës së tij, shteti ynë, Republika e Kosovës, ka shënuar arritje vendimtare dhe do të ishte e pandershme t'i mohojmë apo nënvlerësojmë ato.

Shteti ynë qëndron fuqishëm në orientimin e tij perëndimor, në identitet dhe vlera.

113 shtete e kanë njohur sovranitetin tonë dhe kjo nuk është pak, kur kemi parasysh rrethanat e një bashkësie ndërkombëtare shumë komplekse dhe me plot kontradikta.

Por, njohjet e shtetit tonë do të vazhdojnë për aq sa do të jetë e sigurt edhe rruga jonë drejt integritetit dhe anëtarësimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Tanimë jemi pjesë e shtëpisë botërore të futbollit, FIFA-s, ndërsa sportistët tanë janë duke shkëlqyer në garat sportive ndërkombëtare.

Dua ta përmend dhe ta falënderoj në mënyrë të veçantë heroinën e re të Kosovës, Majlinda Kelmendi, që lartësoi flamurin e shtetit tonë kudo që shkoi, duke qenë e para, duke qenë e arta.

Ajo na kë bërë krenarë të gjithëve, duke i dëshmuar botës potencialin e jashtëzakonshëm që ka vendi ynë dhe rinia jonë.

Në anën tjetër, Forca e Sigurisë së Kosovës është gati të marrë rolin e saj të domosdoshëm në arkitekturën e sigurisë rajonale dhe globale.

Kosova do t'i kontribuojë paqes dhe sigurisë globale kudo që kërkohet nga ne.

Tanimë këtë e kemi dëshmuar, duke qenë pjesë aktive dhe efektive e koalicionit global në luftën kundër terrorizmit.

Ne kemi vizion të qartë për t'u bërë anëtar i NATO-s, organizatës më të madhe të sigurisë dhe rendit demokratik në botë. Ne do të jemi anëtar të NATO-s. Për këtë kemi garancinë e plotë të partnerëve tanë ndërkombëtarë, në rend të parë, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në vizitën e fundit që kisha në Pentagon pashë vullnetin e vendosur të aleatëve tanë amerikanë për të mbështetur procesin e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri të ardhme të Kosovës.

Ushtria është elementi bazik i një shteti, prandaj ashtu sikurse shtetin e Kosovës e kemi bërë bashkë me aleatët tanë, njëjtë edhe ushtrinë e Kosovës do ta bëjmë bashkë me aleatët tanë.

Të nderuar të pranishëm,

Në planin e brendshëm të gjithë treguesit flasin për një konsolidim të vlerësuar të sistemit tonë institucional, demokracisë, sundimit të ligjit, efikasitetit të administratës publike dhe thellim të reformave në sistemin tonë të drejtësisë.

Arritja e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Evropian dhe përmbushja e të gjitha kriterëve teknike për marrjen e liberalizimit të vizave, janë tregues të qartë në këtë qëllim dhe vizion.

Por, ne kemi ende shumë për të bërë në forcimin e shtetit ligjor, në përmirësimin e klimës investive në vend, orientimin tonë kah rinia, veçanërisht investimet në inovacion, në teknologjinë informative, në industrinë prodhuese dhe punësimin e armatës sonë të të rinjve.

Do të veprojmë në këtë drejtim nëpërmjet politikave afirmative, që do të ngrenë imazhin e vendit në botën e jashtme dhe komunikimin më të mirë politik brenda nesh. Është koha për një qasje të re mes nesh. Kjo do të thotë të kemi më shumë afërsi me njëri-tjetrin dhe më shumë besim te njëri-tjetri.

Më shumë përkushtim dhe përgjegjësi për vendin dhe qytetarët, të cilët ne i përfaqësojmë. Të punojmë në një agjendë të përbashkët që ka në epiqendër zhvillimin ekonomik të vendit. Të marrim së bashku përgjegjësitë dhe vendimet e duhura për vendin dhe qytetarët tanë. Të gjejmë rrugët që fëmijët dhe të rinjtë tanë të kenë shkollim më të mirë, më shumë vende pune, më shumë mirëqenie dhe shërbime shëndetësore më efektive për familjet e tyre.

Ky është atdheu ynë dhe ne kemi obligim që t'ua lëmë në dorë gjeneratave që vijnë një shtet krenar, me identitet të qartë politik dhe me një të ardhme të qartë ekonomike.

Republika e Kosovës ka perspektivë të sigurt zhvillimore të integritit euro-atlantik. Ne jemi shtet i qëndrueshëm. Ne besojmë te vetja. Ne besojmë tek atdheu ynë, Kosova.

Urime Dita e Pavarësisë të gjithë qytetarëve të Republikës sonë!
Lavdi dëshmorëve të atdheut!
Zoti e bekoftë Kosovën! Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar të pranishëm,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Kjo ishte pjesa festive e 9-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë sonë. Duke ju falënderuar për pjesëmarrje, i mbyll punimet e kësaj seance solemne.

Ju faleminderit të gjithëve!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*